

SI SHPËTOHEN PENSIONET?

nga Fatos ÇOÇOLI,

botuar në gazetën "Panorama" më 11 shkurt 2014

Është në nderin e shumicës së sotme qeverisëse që kërkon të nisë reformën në pensionet e Shqipërisë. Qeveria e mëparshme, në tetë vite drejtim, nuk guxoi ta merrte përsipër, aq mision i pamundur dhe me kosto të jashtëzakonshme shoqërore i dukej. Ishim dhe vazhdojmë të mbetemi vendi i fundit në Evropë (ndoshta Moldavia na rivalizon) për numrin e të punësuarve në shtet apo privat, që me pagesën e tyre të sigurimeve shoqërore mbajnë një pensionist (tek ne është 1.1 kontribues për 1 pensionist). Nga ana tjetër, në 24 vite tranzicion, pensionet e rreth 600 mijë shqiptarëve të Shqipërisë, edhe pse u rritën vazhdimisht, për shkak të bazës shumë të vogël nga u nisën, ngelën qesharake dhe nuk mjaftojnë në shumë raste as për mbijetesë. Sot edhe ato, në masën e tyre aq të vogël, rrezikohen nga një borxh në rritje i strukturës shtetërore që merret me pagimin e tyre, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që gjithnjë e më tepër i është varur në qafë Buxhetit të Shtetit. Kjo, për faktin se gjithnjë e më pak punonjës të sotëm duan të kontribuojnë (rreth gjysma syresh ose deklarojnë paga më të ulta, ose punojnë në të zezë) dhe numri i atyre që janë në pension rritet nga viti në vit. Jemi në kushtet e një rrethi vicioz, i cili mund të prishet vetëm nga një strukturë që ia vlen të fuqizohet një orë e më parë, Inspektorati Shtetëror i Punës. Ajo duhet të kthehet në "qenin besnik" të qeverisë, që nuhat dhe zbulon "drogën" e të punësuarve në të zezë, ose të atyre që, në marrëveshje me sipërmarrësit, fshehin pagën e vërtetë (e cila është shumë më e lartë), për të kontribuar më pak për pensionet. Një auditim i Kontrollit të Lartë të Shtetit i pak muajve më parë, zbuloi se inspektorët e këtij Inspektorati nuk njohin situatën e kompanive që zhvillojnë aktivitet në territorin që mbulojnë. Inspektorati ka të rregjistruar në shkallë vendi 22 mijë subjekte fizike dhe juridike që kontrollon, ndërkohë që në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në drejtoritë e tatimeve janë rregjistruar 79 mijë subjekte. Me fjalë të tjera, rreth 240 inspektorëve të Inspektoratit ju mungojnë të dhënat për 57 mijë kompani të mëdha e të vogla. Sikur të marrim një mesatare prej 4 punonjësish për kompani, del se Shteti ynë nuk arrin të shikojë se sa janë rrogat dhe sa janë kontributet për pensionet për afro 200 mijë të punësuar në Shqipëri. Prej këtu duhet filluar reforma. Këta 200 mijë të punësuar

duhet të “kapen” nga radarët e Shtetit. Grupi i punës për reformën e pensioneve, që u mbledh dy ditë më parë, bëri mirë kur deklaroi nisjen e reformës dhe ia vlen ta përgëzojmë për kurajon. Ky grup po ashtu deklaroi se në muajin mars të këtij viti do të bëjë një konferencë, ku do të ketë edhe mendimdhënës të huaj (nëse na lejohej t’i quajmë kështu specialistët e huaj të institucioneve të nderuara si Banka Botërore, etj.) dhe do të miratohet dokumenti për politikën për zhvillimin e skemës së pensioneve. Prapë mirë. Po pastaj? Vullnetmirët e grupit të punës do të përgjigjeshin: “në bazë të dokumentit, do të kryhen ndërhyrjet në legjislacion dhe do të dalin aktet përkatëse nënligjore”. Mirëpo opinioni publik dhe qytetarët e thjeshtë, të shqetësuar që asgjë nuk ka lëvizur tek pensionet shqiptare për gati 24 vjet, kanë të drejtë të pyesin prapë: po pastaj? Është për të uruar që në përbërjen e grupit të punës të jenë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe sidomos të tatimeve, por edhe të Ministrisë së Drejtësisë. Që grupi të ketë dhe tagër, dhe mbështetje ligjore e financiare që të punojë gati çdo ditë, pse përpjekja për të përmirësuar gjendjen katastrofike të pensioneve në Shqipëri kërkon forcë herkuliane. Urojmë po ashtu që gjithshka të mos shndërrohet në një prezantim dëshirash të mira për mediat dhe publikun sot dhe në mars. Që edhe deri në muajin mars, në konferencën kombëtare, diçka të ketë lëvizur dhe numri i 200 mijë të punësuarve jashtë radareve të Shtetit të jetë pakësuar. Që në paketën e marsit, propozimi për rritjen apo ashpërsimin e gjobave dhe sanksioneve të tjera për kompanitë që punësojnë në të zeze ose fshehin pagat reale të punonjësve, të jetë i pranishëm. Këto mund të duken shumë urime apo punë për të bërë sa më shpejt, por po të kryheshin, do ta kishim nisur me këmbën e mbarë reformën e gjatë 30 apo dyzet vjeçare të pensioneve. Diejt që nuk ngrohin, të së ardhshmes së skemës së pensioneve private apo heqjes së tavanit të pensionit më të lartë, janë pak ose asgjë për të shpëtuar nga rreziku i katastrofës pensionet e sotme shqiptare. Nëse reformatoret e sotëm do të zotoheshin publikisht se deri në fund të këtij viti do të jenë në gjendje që numrin e kontribuesve për një pensionist ta rrisin nga 1.1 në 1.(pra të fusin në skemë 60 mijë kontribues të rinj), kjo po që do të ishte vrull e kurajo reformatore dhe nisja e shpëtimit të pensioneve shqiptare.